



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 785/3 Prot

Tiranë, më 14.12.2020

V E N D I M

Nr.179, datë 14.12.2020

Mbi përfundimin e hetimit administrativ filluar në bazë të informacionit të përcjellë me kërkesën nr. 785 prot., datë 15.10.2020, të nëpunësit *** , në lidhje me emërimin e kryer nga Departamenti i Administratës Publike të një kandidati nga lista e fituesve, në institucionin Shërbimi Gjeologjik Shqiptar.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, për trajtimin e informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës me nr. 785 prot., datë 15.10.2020, të përcjellë nga nëpunësi ***** , në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë së emërimit të kryer nga Departamenti i Administratës Publike, të kandidatit nga lista e fituesve,

Vërej se:

Nëpërmjet kërkesës nr. 785 prot., datë 15.10.2020, punonjësi ***** , nëpunës civil në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, ngre pretendimin se Departamenti i Administratës Publike, në emërimin e kryer në pozicionin “Specialist në Sektorin e Monitorimit të Rrjetin Lumor”, në Drejtorinë e Hidrogjeologjisë, pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (niveli IV-a), nuk ka respektuar procedurën e përcaktuar në ligj për emërimin në shërbimin civil, sipas së cilës, lëvizja paralele ka përparësi nga pranimi nga jashtë.

Nga verifikimi administrativ i kryer nga Komisioneri, rezulton se, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, në përmbushje të detyrimeve ligjore, me shkresën nr. 1719 prot., datë 24.12.2019, “Dërgohet plani paraprak i nevojave për rekrutim për vitin 2020”, ka dërguar pranë Njesisë

Përgjegjëse DAP, planifikimin për pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, që krijohen të lira gjatë vitit 2020, pozicionet e paplotësuara në vitin 2019, si dhe kriteret për secilin pozicion pune.

Mbi këtë bazë, Departamenti i Administratës Publike, shpalli procesin e konkurrimit me kod #2437 – lloji i diplomës “*Inxhinjeri Gjeologjike/Gjeologji Inxhinjerike dhe Hidrogeologji*”, niveli minimal i diplomës “*Bachelor*”, për grupin e pozicioneve:

- *Specialist në Sektorin e Ujërave Nëntokësore, në Drejtorinë e Hidrogeologjisë, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar – kategoria IV-b;*
- *Specialist në Sektorin e Monitorimit të Lumenjve, në Drejtorinë e Hidrogeologjisë, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar – kategoria IV-b;*

Në përfundim të këtij procesi, ku dolën disa konkurrentë të suksesshëm me mbi 70 pikë, pas emërimit të konkurrentëve të parë me më shumë pikë, të tjerët, Komiteti i Përhershëm i Pranimit i renditi në një listë, në pritje për emërim prej saj, gjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së listës.

Ndërkaq, me krijimin e një pozicioni vakant, me kategori të njejtë, në të njëjtin sektor, për arsye të daljes së punonjësit të mëparshëm në pension pleqërie, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, me shkresën nr. 989/1 prot., datë 21.9.2020, ka kërkuar nga Departamenti i Administratës Publike, plotësimin e pozicionit, “*Specialist në Sektorin e Monitorimit të Rrjetin Lumor*”, në Drejtorinë e Hidrogeologjisë, pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (kategoria e pagës IV-a), me kandidatë nga lista fituese.

Në këtë rast, Departamenti i Administratës Publike, nisur nga kërkesa e institucionit, në emërimin e kryer, ka vepruar bazuar në përcaktimet e pikës 1, të nenit 23, të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, i ndryshuar, ku parashikohet se vendet vakante të krijuara në mënyrë të përkohshme apo të përhershme mund të plotësohen me kandidatë fitues nga lista e pritjes. Sipas kësaj dispozite, kandidatët e suksesshëm, të përcaktuar sipas pikës 5, të nenit 22, të këtij ligji, duke filluar nga ai me më shumë pikë, kanë të drejtën të zgjedhin të emërohen në çdo pozicion të grupit, për të cilin është zhvilluar konkurrimi, si dhe në çdo pozicion tjetër të lirë të të njëjtit grup, që krijohet i lirë gjatë kohës së vlefshmërisë së listës, në përputhje me pikën 3 të këtij neni.

Në kuptim të ligjit për nëpunësin civil, pozicione të të njëjtit grup, konsiderohen ato pozicione për të cilat kriteret e veçanta, përshkrimi i përgjithshëm i punës dhe fusha e njohurive, përputhen.

Në këtë rast, Departamenti i Administratës Publike, me të drejtë, ka emëruar në pozicionin e lirë të krijuar, kandidatin që kishte mbetur i pari në listë, por që nuk ishte emëruar në përfundim të procesit të konkurrimit. Në këtë mënyrë, emërimi i kryer nga Departamenti i Administratës Publike për plotësimin e vendit vakant, është kryer në përputhje me përcaktimet e legjislacionit të shërbimit civil, brenda të njëjtës kategori dhe grupit të pozicioneve ku kriteret e veçanta, përshkrimi i punës dhe fusha e njohurive përputhen me specifikimet e vendosura nga institucioni në shkresën nr. 1719 prot., datë 24.12.2019, “Dërgohet plani paraprak i nevojave për rekrutim për vitin 2020”, drejtuar Departamentit të Administratës Publike.

Nga sa u theksua më sipër, Komisioneri vlerëson se, plotësimi i pozicionit vakant, të krijuar pas daljes së punonjësit në pension pleqërie, “*Specialist në Sektorin e Monitorimit të Rrjetin Lumor*”, në Drejtorinë e Hidrogeologjisë, pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (kategoria e pagës IV-a), nuk kërkon një shpallje të re për pranim në shërbimin civil, për të cilin ngre pretendimin kërkuesi, por me të drejtë, është plotësuar nga Departamenti i Administratës Publike, nëpërmjet emërimit nga lista e fituesve, sipas përcaktimit të pikës 1, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Nga sa është parashtruar më sipër, në analizë të dokumentacionit të administruar dhe fakteve të çështjes konkrete, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil arrin në përfundimin se pretendimi i nëpunësit *****, që Departamenti i Administratës Publike, në emërimin e kryer në këtë rast nga lista e fituesve, nuk ka respektuar procedurën e përcaktuar në ligj për emërimin në shërbimin civil, sipas së cilës, lëvizja paralele ka përparësi nga pranimi nga jashtë, është i padrejtë.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, si dhe në nenin 34, pika 1, të Rregullores, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ filluar në bazë të kërkesës nr. 785 prot., datë 15.10.2020, të nëpunësit *****, në lidhje me pretendimin për parregullsi të lejuara nga Departamenti i Administratës Publike, në emërimin e një kandidati nga lista e fituesve, në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Monitorimit të Rrjetin Lumor*”, në Drejtorinë e Hidrogeologjisë, pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (kategoria e pagës IV-a), pasi nuk u konstatuan veprime në kundërshtim me ligjin.

2. Të njoftohet për këtë vendim Shërbimi Gjeologjik Shqiptar dhe nëpunësi
*****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha